

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ZYRA E KRYEMINISTRIT - UREDI PREMIERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR			
Niveli dhe Shkronja e Organit	01.3	Nr. Prot. Sh. Prot. Prot. N.	506
Niveli dhe Shkronja e Niv. Prot.	P0	Data: Datimi:	14 / 03 / 20 22
Prishtinë/a			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**

**STATUTI**  
**I NJËSISË PËR AUDITIM TË BRENDSHËM**

Prishtinë, janar 2022

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	3
Misioni dhe Fushëveprimi i punës së NJAB-së.....	3
Llogaridhënia .....	4
Pavarësia .....	5
Përgjegjësia .....	5
Të drejtat e Njesisë për Auditim të Brendshëm dhe Auditorëve të Brendshëm .....	6
Autoriteti.....	7
Standardet e Praktikës së Auditimit.....	8
Hyrja në fuqi.....	9

Në bazë të nenit 25 pika 3.1 dhe 3.2. të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, të standardeve të atributit nr. 1000, 1000.A1, 1000.C.1 dhe 1010 të Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe pikës 3.1.2 të Doracakut të Auditimit të Brendshëm, drejtori i Njesisë për Auditim të Brendshëm nxjerr dhe dorëzon për miratim te Kryeministri dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit këtë:

## STATUT TË NJËSISË PËR AUDITIM TË BRENDSHËM NË ZYRËN E KRYEMINISTRIT

### NENI I

#### Hyrje

Statuti i Njesisë për Auditim të Brendshëm (NJAB) është përgatitur dhe përpunuar vetëm për nevojat e NJAB-së në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Përmes këtij statuti janë definuar disa të drejta dhe përgjegjësi të përgjithshme të NJAB-së, të cilat janë të parapara me Ligjin Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren QRK-Nr.01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektet e Sektorit Publik. Statuti mbështete në SNAB, Standardi 1000 i cili përcakton misionin, fushëveprimin, autoritetin dhe përgjegjësit e funksionimit të Auditimit të Brendshëm.

Roli i Auditimit të Brendshëm është që të ndihmoj menaxhmentin e Zyrës së Kryeministrit të arrijë objektivat e saj, duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Njësi për Auditim të Brendshëm gjatë kryerjes së punëve bazohet në Ligjin Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Doracakët e Auditimit të Brendshëm, kodit të etikës dhe sjelljes, ligjet tjera, si dhe procedurat dhe politikat që zbatohen nga Zyra e Kryeministrit.

### NENI II

#### MISIONI DHE FUSHËVEPRIMI I PUNËS SË NJAB-së

- 2.1 Misioni i Njesisë për Auditim të Brendshëm (NJAB), është të ofroj shërbimet të pavarura, objektive, siguroese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtojnë vlerën dhe të përmirësojnë aktivitetet (punën) e Zyrës së Kryeministrit. NJAB i ndihmon Zyrës së Kryeministrit që të arrij objektivat e saja duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar

për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

2.2 Fushëveprimi i punës së Njesisë për Auditim të Brendshëm, është që të përcaktoj nëse rrjeti i Zyrës së Kryeministrit për proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes siç është dizajnuar dhe përfaqësuar nga menaxhmenti, është adekuat dhe funksionon në atë mënyrë që të siguroj që:

- Rreziqet të identifikohen dhe menaxhohen si duhet;
- Ndërveprimi me grupet e ndryshme të qeverisjes të ndodhë sipas nevojës;
- Informata të mjaftueshme financiare, menaxheriale dhe operative të janë të sakta, të besueshme dhe me kohë;
- Veprimet e punonjësve të janë në pajtueshmëri me politikat, standardet, procedurat dhe ligjet e rregulloret e aplikueshme;
- Burimet të sigurohen në mënyrë ekonomike, të përdoren me efikasitet dhe të mbrohen në mënyrë adekuate;
- Të arrihen programet, planet dhe objektivat;
- Cilësia dhe përmirësimi i vazhdueshëm të promovohen në procesin e kontrollit të Zyrës së Kryeministrit; dhe
- Çështjet e rëndësishme legislative ose rregullatorë që kanë ndikim në Zyrën e Kryeministrit të janë pranuar dhe adresuar si duhet.

2.3 Mundësit për përmirësimin e kontrollit të menaxhmentit, fitimprurës dhe imazhit të Zyrës së Kryeministrit mund të identifikohen gjatë auditimeve. Ato do të komunikohen te nivelet adekuate te menaxhmenti i lartë dhe Komiteti i Auditimit.

2.4 Fushëveprimi ose periudha që auditohet nga NJAB do të përcaktohet paraprakisht bazuar në planin strategjik dhe vjetor, dhe do të auditohen sipas shkallës (koeficienteve) së rrezikut të cekur në planin strategjik të NJAB-së gjithnjë sipas gjasës dhe ndikimit nëse ndodh ai rrezik.

### NENI III

### LLOGARIDHËNIA

Drejtori i Njesisë për Auditim të Brendshëm, në përmbushjen e detyrave të tij do të jetë llogaridhënës ndaj Kryeministrit, Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore Harmonizuese (NJQH) në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) që të:

- Ofroj për çdo vit vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetin e proceseve të Zyrës së Kryeministrit për kontrollimin e aktiviteteve të saja dhe menaxhimin e rreziqeve të saja në fushat e vënë nën misionin dhe fushëveprimin e punës;
- Të raportoj çështjet e rëndësishme që ndërlidhen me proceset për kontrollimin e aktiviteteve të Zyrës së Kryeministrit dhe partnerëve të saj, përfshirë edhe përmirësimet potenciale të atyre proceseve dhe ofrimin e informatave për sa i përket çështjeve të tilla nëpërmjet të zgjidhjeve;
- Ofroj periodikisht informatat mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të Njesisë; dhe
- Koordinoj dhe mbikëqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimin e rrezikut, pajtueshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).

#### NENI IV

#### PAVARËSIA

Njësia e Auditimit të Brendshëm ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe i raporton drejtpërdrejt vetëm Kryeministrit dhe e njofton Komitetin e Auditimit.

Në raport me strukturat tjera organizative në Zyrën e Kryeministrit, Njësia për Auditimin e Brendshëm ka pavarësinë funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.

NJAB gjatë punës duhet ti përmbahet parimeve për funksionimin e auditimit të brendshëm sipas nenit 18 të ligjit nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, dhe nuk ndikohet nga personat me autoritet nga brenda ose jashtë organizatës.

#### NENI V

#### PËRGJEGJËSIA

Drejtori dhe personeli i Njesisë për Auditim të Brendshëm, kanë përgjegjësinë që të:

- Harton planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm, duke përdorur metodologjinë adekuate që bazohet në rrezik, përfshirë çfarëdo shqetësimi për rrezik ose kontrole të identifikuar nga menaxhmenti dhe të dorëzoj këto plane te Komiteti i Auditimit dhe Kryeministri për rishikim dhe miratim, pas miratimit i dorëzon te NJQH më së largu deri me 31 dhjetor të vitit fiskal;

- Zbatoj planin vjetor të auditimit siç është miratuar përfshirë edhe ndonjë detyrë ose projekt special siç është e përshtatshme e që kërkohen nga Kryeministri dhe Komiteti i Auditimit;
- Mirëmbaj personel profesional të auditimit me njohuri të mjaftueshme, shkathtësi, përvojë dhe certifikime profesionale për të përmbushur kërkesat e këtij Statuti;
- Themeloi programin e sigurimit të cilësisë me anë të së cilit Drejtori i Njësisë për Auditim të Brendshëm siguron funksionimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm;
- Kryej shërbime këshillëdhënëse, përtej shërbimeve të auditimit të brendshëm për siguri, të asistoj menaxhmentit në arritjen e objektivave të tija. Shembujt mund të përfshijnë lehtësimin, dizajnimin e procesit, trajnimin dhe shërbimet këshillëdhënëse;
- Evaluoj dhe vlerësoj funksionet e rëndësishme të shkrira/konsoliduara dhe shërbimet, proceset, operacionet dhe proceset e kontrollit që janë të reja ose në ndryshim e sipërm që koincidojnë me zhvillimet e tyre, zbatimin dhe/ose shtrirjen;
- Përgatitë dhe dorëzon raporte periodike (gjashtë mujore parë, dytë si dhe raportin vjetor) tek Kryeministrin, Komiteti i Auditimit dhe NJQH më së largu deri me 15 korrik të vitit dhe deri me 15 janar të vitit vijues;
- Ofroj një listë të synimeve dhe rezultateve të rëndësishme të matjes për komitetin e auditimit;
- Asistoj në hetimin e aktiviteteve të rëndësishme të dyshuara për mashtrim brenda organizatës dhe të njoftoj Kryeministrin dhe Komitetin e Auditimit për rezultatet; dhe
- Të merret parasysh fushëveprimi i punës së auditorëve të jashtëm dhe rregullatorëve siç duhet, për qëllim të ofrimit të mbulimit optimal të organizatës me auditim me një kosto të arsyeshme të përgjithshme.

## NENI VI

### TË DREJTAT E NJËSISË PËR AUDITIM TË BRENDSHËM DHE AUDITORËVE TË BRENDSHËM

Njësia për Auditim të Brendshëm ose Auditori i Brendshëm që bëjnë një auditim të ligjshëm sipas këtij ligji, janë të autorizuar dhe kanë përgjegjësinë që:

- 6.1 Të bëjë auditime të brendshme në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, statuti i auditimit të brendshëm, kodi i etikës dhe standardet profesionale të miratuara nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve;

- 6.2 Të marr, shqyrtojë dhe shfrytëzojë pa kufizim të gjitha të dhënat teknike, ekonomike , financiare si dhe informatat e dokumentet në posedim ose kontroll të njësive organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, që kanë të bëjnë me kryerjen e auditimit;
- 6.3 Të kopjojë të dhënat, informatat apo dokumentet e tilla për qëllime të auditimit të brendshëm si dhe të sigurojë që kopjet në fjalë të jenë ose origjinale ose të certifikuara. Dokumentet origjinale duhet ti kthehen të gjitha njësive strukturore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit nga i cili janë marrë për shfrytëzim;
- 6.4 Të kërkojë nga cilido zyrtar, punonjës, këshilltar ose kontraktues i subjektit të sektorit publik nën auditim që të ofrojë dëshmi fizike, shënime dhe dëshmi gojore ose informata të tjera mbi çështjet që kanë të bëjnë me auditimin ose mbi aktivitetet që janë nën auditim;
- 6.5 Të ketë qasje pa pengesë në pasurinë e subjektit të sektorit publik nën auditim, dhe të verifikojë dhe vlerësojë vlerat materiale dhe monetare të Zyrës së Kryeministrit në pajtim me rregullat dhe legjislacionin;
- 6.6 Të raportojë tek menaxhmenti i lartë i Zyrës së Kryeministrit mbi te gjitha çështjet materiale të lidhura me kryerjen e auditimit të brendshëm dhe me rezultatet e tij;
- 6.7 Të marr informata të certifikuara nga Thesari, Banka Qendrore e Kosovës dhe cilado organizatë publike apo private në lidhje me xhirollogaritë dhe/ose transaksionet aktuale ose të mbyllura që përfshijnë subjektet nën auditim mbi të cilin Njësia për Auditim të Brendshëm ka kompetenca;
- 6.8 T'i propozojë menaxhmentit të lartë të Zyrës së Kryeministrit kontraktimin e personelit të ekspertëve atëherë kur kërkohen njohuri dhe aftësi të veçanta në lidhje me aktivitetet e planifikuara të auditimit të brendshëm;
- 6.9 Të ketë qasje në Komitetin e Auditimit dhe të marrë pjesë në seancat e tij;
- 6.10 Të përcaktojë objektivat, fushëveprimin, shpeshhtësinë, metodat dhe burimet e nevojshme për kryerjen e Auditimit të Brendshëm; dhe
- 6.11 Të mbajnë në fshehtësi të gjitha informacionet që atyre u janë bërë të njohura gjatë kryerjes së auditimit të brendshëm, përveç nëse ligji kërkon ndryshe.

## NENI VII

### AUTORITETI

- 7.1 Drejtori dhe personeli i Njesisë për Auditim të Brendshëm janë të autorizuar që të:
  - Kenë qasje të pakufizuar në të gjitha funksionet, të dhënat, pronën dhe personelin;
  - Kenë qasje të plotë dhe të lirë në Komitetin e Auditimit;

- Alokoj burimet, vendos frekuencat, përzgjedhë temat, përcaktoj fushëveprimin e punës dhe aplikoj teknikat e kërkuara për të arritur objektivat e auditimit; dhe
- Marr asistencën e nevojshme të personelit në njësitë e organizatës ku ata kryejnë auditimet, si dhe shërbimet e tjera të specializuara nga brenda organizatës ose jashtë saj.

7.2 Drejtori dhe personeli i Njesisë për Auditim të Brendshëm nuk janë të autorizuar që të:

- Kryejnë ndonjë detyrë operative për organizatën ose partnerët e saj;
- Inicioj ose miratoj transaksionet e kontabilitetit që janë jashtë Njesisë për Auditim të Brendshëm; dhe
- Drejtoj aktivitetet e punonjësve të organizatës që nuk janë të punësuar nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, përveç deri në atë shkallë kur punonjësit e tillë janë caktuar në ekipet e auditimit si duhet, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar auditorët e brendshëm.

## NENI VIII

### STANDARDET E PRAKTIKËS SË AUDITIMIT

Aktivitetet e auditimit të brendshëm të Njesisë së Auditim të Brendshëm duhet të jenë në pajtueshmëri me standardet profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, të vendosura nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, si dhe në pajtim me parimet e sjelljes të Kodit të Etikës.

Qëllimi i standardeve është që të:

- Bëjnë identifikimin e parimeve bazë, të cilat janë udhëzues të praktikës së auditimit të brendshëm;
- Ofrojnë kornizën për kryerjen e një vargu të gjatë të aktiviteteve të auditimit të brendshëm që e shtojnë vlerën;
- Vendosin bazat për vlerësimin e performancës së auditimit të brendshëm; dhe
- Ndihmojnë përmirësimin e veprimeve dhe proceseve të organizatës.

Njësia e Auditimit të Brendshëm do të përmbush ose tejkaloj Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të brendshëm të Institutit të Auditorëve të Brendshëm.



**NENI IX**

**Hyrja në fuqi**

Ky statut hyn në fuqi në datën e miratimit (nënshkrimit) nga Drejtori i Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Kryeministri dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

Lumni Kryeziu



Drejtore i Njesisë për Auditim të Brendshëm

Albin Kurti



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Arta Hoxha



Kryesuese e Komitetit të Auditimit

Datuar me: 24. 01. 2022